



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	13 - 10 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHK	6169/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 744/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca - anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr. 744/2022 të datës 30.08.2022, të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Shtërpcës, kundër organit të punësimit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.10.2022, mori këtë.

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht** si e bazuar ankesa A.nr.744/2022, e datës 30.08.2022 e parashtruar nga ankuesi lidhur me ruajtjen e statusit të nëpunësit civil, ndërsa **Refuzohet** si i pa bazuar pretendimi ankimor lidhur me vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Autoritetet Kosovar të Konkurrencës.
- II. **Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kësaj vendimi, të bëjë emërimin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë.
- III. **Obligohet** Kryetarja e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Ar sy e t i m

Ankuesi në bazë të Vendimit me Nr.31/19 të datës 13.08.2019 të Kryetari i Autoritetet Kosovar të Konkurrencës, është emëruar në pozitën "Drejtor i Përgjithshëm", në Sekretariatit e Autoritetet Kosovar të Konkurrencës, në kohëzgjatje nga tri (3) vite me mundësi vazhdimi, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve të brendshme të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Me datë 08.08.2022, përmes e-mailit Kryetarja e Autoritetet Kosovar të Konkurrencës, ka njoftuar ankuesin lidhur me përfundimin e marrëdhënies se punës për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" në Sekretariatit e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që nga data 13.08.2022, pasi që i njëjti nuk do të vazhdohet.

Ankuesi, kundër njoftimit të datës 08.08.2022, përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 29.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 30.08.2022 me numër protokollit 5018/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 05.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Ndërsa me datë 09.09.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 744/2022, e datës 30.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.08.2019, me numër protokollit 225/19-0313, i Kryetarit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës; Akt Emërimi i datës 13.08.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; e-maili i datës 08.08.2022; e-maili i datës 15.08.2022; e-maili i datës 03.08.2022; kërkesë e datës 16.05.2022, me numër protokollit 144/22-06/B; përgjigje në kërkesë e datës 24.05.2022; Përgjigje në ankesë e datës 09.09.2022, me numër protokollit 5245/2022, me shkresat e bashkangjitura; Parashtrësë për KPMSHCK lidhur me ankesën e ankuesit dërguar nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës e datës 05.10.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar sepse:

Nga administrimi i provave, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pas procedurës së rekrutimit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Sekretariatit e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ankuesi sipas Vendimit me Nr.31/19 të datës 13.08.2019 të Kryetarit të Autoritetet Kosovar të Konkurrencës, është emëruar në këtë pozitë për një mandat tre (3) vjeçar (nga data 13.08.2019 deri më datë 13.08.2022), rrjedhimisht emërimi i ankuesit në këtë pozitë është bërë duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve të brendshme të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka filluar të aplikohet nga data 09.07.2020, në dispozitat transitorë është rregulluar statusi i pozitive të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës apo ligjeve të tjera, gjegjësisht me nenin 83 paragrafi 6 dhe 7 të këtij ligji është përcaktuar se: *“6. Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës. 7. Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore ose në një institucion tjetër shtetëror, i cili nuk është emëruar në këtë pozitë sipas procedurave të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin sipas ligjit të aplikueshëm në momentin e emërimit të tij/saj”*, rrjedhimisht ankuesi edhe pasi që ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka mbajtur pozitën e tij për kohën sa ka qenë i emëruar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se lidhur me vazhdimin e mandatit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese e të cilët kanë shërbyer vetëm një mandat sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, siç parashihet me paragrafin 8 të nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e tij/saj të parë, do të aplikohet neni 42, paragrafi 2 i këtij ligji”*, në rastin konkret për vazhdimin e mandatit aplikohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *“Rizgjatja e mandatit, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, miratohet nga Qeveria, me propozim të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në performancën e tij. Propozimi bëhet të paktën 3 muaj para përfundimit të mandatit. Në rastin e institucioneve të tjera shtetërore, vendimi për rivazhdimin e mandatit merret nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”*, rrjedhimisht vazhdimi i mandatit është në diskrecion të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese, në rastin konkret të ankuesit ka qenë në diskrecion të Kryetares së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që t’i vazhdoj apo jo mandatin e ankuesit, ndërsa në rastin konkret nuk ka shprehur gatishmëri për vazhdimin e mandatit të ankuesit, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se legjislacioni në fuqi nuk obligon që vazhdimi i mandatit të jetë i detyrueshëm, po ashtu në bazë të provave të lëndës, ankuesi posedon vetëm vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i cili i është bërë më datë 27.01.2021, ndërsa nuk ka vlerësim të rezultateve në punë për vitin 2021 për faktin që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nga qershori 2021 deri në qershor 2022 ka qenë jofunksional. Andaj duke u bazuar në këto rrethana lidhur pretendimin ankimor të ankuesit që në rastin konkret është dashur të nxirret vendim për përfundim të mandatit, ndërsa që njoftimi i datës 08.08.2022 nuk përmban elementet e aktit administrativ, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përfundimi i mandatit të ankuesit është fakt notor që të njëjtit i ka përfunduar mandati më datë 13.08.2022, ndërsa nuk është obligim ligjor që në rastet e tilla të nxirret vendim, mirëpo që ankuesi është njoftuar që nuk do ti vazhdohet mandati, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që statusi i nëpunësit civil nuk i ka humbur sipas njoftimit të datës 08.08.2022, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës është përcaktuar se: *“Autoriteti është agjenci e pavarur, që për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës”*,

rrjedhimisht themelimi i agjencive të pavarura është përcaktuar me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ndërsa Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, është i paraparë me shtojcën 1, i renditur në numrin rendor 61, duke u bazuar në këtë Autoritetit Kosovar i Konkurrencës meqenëse është agjenci e pavarur, kategorizohet si institucion tjetër shtetëror siç parashihet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-14 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1.2.institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me mbarimin e mandatit të nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese në rastet që nuk i vazhdohet mandati, atëherë për këta nëpunës Njësia e Pranimit detyrohet që të emëroj në pozitë të kategorisë së mesëm drejtues dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale, siç parashihet me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale"* dhe nenin 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *"Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit të nivelit të lartë drejtues nga shërbimi civil, Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore është e obliguar që brenda afatit më të shkurtër kohor, të emërojë nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit profesional"*.

Duke u bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit në asnjë formë nuk mund t'i humb statusi i nëpunësit civil, sepse sipas legjislacionit në fuqi Njësia e Burimeve Njerëzore e Autoritetet Kosovare të Konkurrencës, në pajtim me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, është e obliguar që ankuesin ta emëroj në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit profesional, ndërsa deri në emërimin në një pozitë nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore, siç parashihet me nenin 42 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, andaj edhe pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 744/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Malsore Gashi -BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.